



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albanian Chrome Sh.p.k nga Balfin Sh.p.k

Në datën 17 Janar 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes për Blerjen dhe Shitjen e Abanian Chrome Sh.p.k”, të nënshkruar ndërmjet palëve (Balfin Sh.p.k” në cilësinë e blerësit dhe “DCM DECOMetal GmbH” dhe “ DCM Beteiligungs GmbH” në cilësinë e aksionërve shitës) më datë 9 Janar 2013, me objekt përfitim të kontrollit të shoqërisë Albanian Chrome Sh.p.k nga shoqëria Balfin Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Albanian Chrome Sh.p.k:** ushtron veprimtarinë e saj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit;
- **Balfin Sh.p.k:** ushtron veprimtarinë e saj në fushën e import-eksportit, shitjes meshumicë dhe pakicë të mallrave industriale dhe ushqimorë, tregtimi i mallarev të ndryshëm, transport i mallrave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**